

Pyetjet më të shpeshta lidhur me skemën e granteve

'Avancimi i barazisë dhe diversitetit gjinor përmes eliminimit të diskriminimit me bazë gjinore në vendin e punës'

1: A lejohet partneriteti në projekt i organizatave joqeveritare me institucione publike lokale?

Realizimi i projekteve në partneritet me institucionet publike nuk është i lejuar në kuadër të kësaj thirrjeje. Fokusi i projektit dhe aktiviteteve të parapara duhet të bazohet në punën e organizatës përfituese dhe preferohet që organizatat të jenë të vetme në realizimin e projektit në mënyrë që projekti të jetë më efikas duke kontribuar në rritjen e sinergjisë ndërmjet partnerëve ekzistues.

2: A penalizohen organizatat me përvojë të gjatë në fushat relevante për projektin e propozuar?

Skema e granteve ka për synim mbështetjen e organizatave me bazë në komunitet të cilat definojnë si "Grupe të vetorganizuara të individëve që ndjekin interesa të përbashkëta përmes një organizate vullnetare dhe jo-fitimprurëse" dhe asnjë organizatë që i plotëson kriteret e këtij përkufizimi nuk do të penalizohet për shkak të përvojës së gjatë në fushat e caktuara që mbështeten prej kësaj thirrjeje.

3: A janë të përshtatshme për aplikim grupet joformale të regjistruara?

Kriteret e paraqitura në thirrje specifikojnë se janë të pranueshme për aplikim të gjitha "OSHC-të lokale të regjistruara në Kosovë" pavarësisht formës së tyre të regjistrimit, si shoqatë apo fondacion. Në këtë aspekt, është kusht që ato të jenë të regjistruara pranë divizionit të regjistrimit të OJQ-ve në Ministrinë e Administratës Publike dhe të mbështesin këtë me dokumentacionin përkatës.

4: Nëse shuma e ndarë nga ky grant nuk është e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të projektit, a është i lejuar financimi i aktiviteteve të projektit nga ndonjë skemë tjetër financimi?

Bashkëfinancimi i projektit nga ndonjë skemë tjetër nuk është i lejuar, edhe nëse burimet e bashkëfinancimit vijnë nga fondet e BE-së, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte.

5: Kur do të njoftohemi për rezultatet e aplikimit për grante?

Njoftimi i palëve për statusin e aplikimit të tyre do të bëhet më së largu gjatë mesit të Qershorit 2024.

6: Kur duhet të fillojë implementimi i projekteve?

Nënshkrimi i kontratave me palët përfituese të granteve do të bëhet në Qershor 2024 dhe implementimi i projekteve mund të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

7: Kur është koha më e vonshme për realizimin e projekteve të cilat financohen nga kjo skemë?

Projektet fituese të granteve duhet të implementohen gjatë periudhës gjashtëmujore 15 Qershor 2024 – 15 Dhjetor 2024 prandaj data e fundit për përmbyllje të projektit është 15 Dhjetor 2024.

8: A lejohet aplikimi për financim të aktiviteteve të cilat janë shtesë apo vazhdimësi e aktiviteteve ekzistuese?

Aktivitet e propozuara duhet të jenë pjesë e projektit i ri dhe nuk mund të jenë vazhdimësi e angazhimeve ekzistuese.

10: Cili është kufiri i lejuar i shpenzimeve të personelit si përqindje e buxhetit total të projektit?

Nuk ka kufij të vendosur për shumën e lejuar të shpenzimeve të personelit në projekt përderisa shpenzimet janë të arsyetuara mirë dhe projekti dëshmon qartë se si ato i shërbejnë arritjes së objektivave të projektit të propozuar në kuadër të kësaj thirrjeje.

11: A është e lejuar lëvizja e fondeve në kuadër të vijave buxhetore?

Lëvizja e fondeve është e lejuar përbrenda seksioneve të buxhetit dhe përderisa ato nuk lëvizin nga shpenzimet e drejtpëdrejta të projektit te seksioni mbi personelin (pagat). Në mënyrë që të mos të ketë ndryshime në qëllimin bazë të projektit, kjo lëvizje nuk mund të kalojë mbi 20 % brenda vijave buxhetore të një seksioni të buxhetit.

12: A mund të përfshihen në kuadër të projektit të propozuar aktivitete garuese, si sportive, kulturore etj.?

Aktivitetet garuese mund të përfshihen në kuadër të projektit të propozuar nëse në projekt është e arsyetuar mirë se ato do t'u shërbejnë objektivave të vendosura të projektit dhe të kësaj thirrjeje.

13: A është e lejuar të paraqiten edhe fatura në të cilat është e përfshirë TVSH?

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) nuk është kosto e pranueshme me këtë thirrje dhe si rrjedhojë nuk mbulohet nga mjetet e pranuar nga bartësi i projektit.

Në përputhje me Nenin 5, paragrafi 5, nënparagrafi 5.4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për zbatim të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, organizatat jo-fitimprurëse janë të liruara nga TVSH-ja nëse realizojnë të ardhura nga fonde, grante dhe donacione. Implementuesi i projektit në këtë rast, duhet të ofrojë dëshmi se mallrat/shërbimet e blera financohen nga të ardhurat e donacioneve, në mënyrë që furnizuesi i mallrave/shërbimeve ta bëjë faturimin pa TVSH.

Në rastin kur bartësi i projektit dështon të sigurojë faturimin pa TVSH nga furnizuesi i mallrave/shërbimeve për çfarëdo arsye, atëherë bartësi i projektit duhet t'i paguajë shpenzimet e TVSH-së vetë.

14: Cila është procedura e sigurimit të faturave pa TVSH?

Sipas vendimit shpjegues publik nr. 04/2016, të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, furnizuesit e mallrave/shërbimeve, me rastin e faturimit të projekteve të

financuara nga të ardhurat e donacioneve, faturimin duhet ta bëjnë pa TVSH, duke shënuar në faturë referencën e nenit 33. Paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 05/L-37 për TVSH.

15: Me çfarë dokumentesh duhet të dëshmohet qarkullimi vjetor i një organizate?

Qarkullimi vjetor i një organizate mund të dëshmohet me Deklaratë vjetore të tatimit mbi korporata e cila merret në ATK pas deklarimit të organizatës suaj. Kjo dëshmi do të ju kërkohet nëse jeni pjesë e listës së ngushtë përfituese të skemës financiare nga projekti.

16: A mund të aplikojnë organizatat të cilat janë regjistruar kohës së fundit dhe nuk kanë ende ndonjë projekt të implementuar?

Kjo thirrje nuk ka ndonjë kufizim rreth periudhës së themelimit të organizatës. Andaj, kushti i vetëm është që ato të jenë të regjistruara dhe të jenë në gjendje të ofrojnë dokumentet që dëshmojnë këtë regjistrim.